

**VENDIM**  
**Nr. 892, datë 21.12.2016**

**PËR PËRCAKTIMIN E FUNKSIONEVE KORRESPONDUESE DHE KATEGORIZIMI PËR  
GRADAT  
NË POLICINË E SHTETIT<sup>1</sup>**

*(Ndryshuar me VKM nr.83, datë 14.2.2018)*

*(I përditësuar)*

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 61, të ligjit nr.108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Funkcionet korresponduese dhe kategorizimi për çdo gradë, në Policinë e Shtetit, përcaktohen në lidhjen nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Studenti që përfundon arsimin e lartë policor në një institucion jashtë vendit, të barasvlershëm me Akademinë e Sigurisë, sipas marrëveshjeve të lidhura me shtetin ku studentët kanë përfunduar arsimin, si dhe kanë kryer njohjen dhe njehsimin e diplomave në Republikën e Shqipërisë, konform përcaktimeve në kuadrin ligjor në fuqi për arsimin e lartë, në momentin e emërimit për herë të parë në detyrë i jepet grada “Nënkomisar” dhe i nënshtrohen trajnimit në Akademinë e Sigurisë.

3. Punonjësit e Policisë së Shtetit, të emëruar në bazë të vendimit nr. 917, datë 4.10.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 803, datë 21.11.2007, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e funksioneve korresponduese për gradat në Policinë e Shtetit dhe ekuivalentimin e tyre”, të ndryshuar, në funksione të njëjta apo të barasvlershme me ato të parashikuara në këtë vendim, vazhdojnë të qëndrojnë në këto detyra, duke mbajtur gradën ekzistuese për një periudhë deri në 1 vit. Nëse gjatë kësaj periudhe këta punonjës nuk fitojnë gradën korresponduese të funksionit që mbajnë, emërohen në një funksion tjetër, në përputhje me gradën që kanë.

4. Vendimi nr. 803, datë 21.11.2007, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e funksioneve korresponduese për gradat në Policinë e Shtetit dhe ekuivalentimin e tyre”, i ndryshuar, shfuqizohet.

5. Ngarkohet Ministria e Punëve të Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI**  
**Niko Peleshi**

---

<sup>1</sup> VKM nr. 892, datë 21.12.2016 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.254, 30 dhjetor 2016.  
VKM nr. 83, datë 14.2.2018 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.22, 19 shkurt 2018.

Lidhja nr. 1

TABELA E FUNKSIONEVE KORRESPONDUESE DHE KATEGORIZIMI PËR ÇDO GRADË <sup>2</sup>

GRADAT	NUMRI LIMIT PËR GRADË	FUNKSIONET
Drejtues Madhor	1	Drejtor i Policisë së Shtetit.
Drejtues i Lartë	6	Zëvendësdrejtor i Policisë së Shtetit, Drejtorët e Përgjithshëm.
Drejtues i Parë	52	<p><b>A. <u>Në strukturat e Drejtorisë së Policisë së Shtetit</u></b></p> <p>1. Drejtor, në Drejtorinë e Policisë së Shtetit;                  2. Drejtor, në Drejtoritë e Përgjithshme.</p> <p><b>B. <u>Në strukturat e veçanta</u></b></p> <p>1. Shef Zyre, në Zyrën Ndihmëse të Drejtorit të Policisë së Shtetit;                  2. Këshilltar, në Zyrën Ndihmëse të Drejtorit të Policisë së Shtetit;                  3. Shef Sektori, në Drejtorinë e Studimeve Strategjike;                  4. Drejtor, në Drejtorinë e Antiterrorit, në Institutin e Policisë Shkencore, në Drejtorinë e Forcës së Posaçme Operacionale, në Drejtorinë e Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë dhe Drejtorinë e Teknologjisë së Informacionit dhe funksione të barasvlershme me to.</p>

<sup>2</sup> Shënim. Në lidhjen nr. 1, "Tabela e funksioneve korresponduese dhe kategorizimi për çdo gradë", numri limit për gradën "Drejtues i lartë" bëhet 7 dhe numri limit për gradën "Kryekomisar" bëhet 453 me VKM nr.83, datë 14.2.2018.

		<p><b>C. <u>Në Akademinë e Sigurisë</u></b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Drejtor/Dekan;</li> <li>2. Drejtor i Qendrës Kërkimore-Shkencore;</li> <li>3. Përgjegjës Departamenti, në Fakultet;</li> <li>4. Profesor;</li> <li>5. Drejtor i Kolegjit Profesional të Lartë;</li> <li>6. Drejtor i Planifikimit dhe Kontrollit;</li> <li>7. Drejtori/Administratori dhe funksione të barasvlershme me to.</li> </ol> <p><b>D. <u>Në strukturat e Drejtorive Vendore të Policisë</u></b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Drejtor i Drejtorive Vendore të Policisë.</li> </ol>
<p style="text-align: center;"><b>Drejtues</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>136</b></p>	<p><b>A. <u>Në strukturat e Drejtorisë së Policisë së Shtetit</u></b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Shef sektori, në Drejtorinë e Policisë së Shtetit dhe Drejtoritë e Përgjithshme;</li> <li>2. Asistent i Zëvendës Drejtorit të Policisë së Shtetit;</li> <li>3. Asistent i Drejtorit të Përgjithshëm, në Policinë e Shtetit;</li> <li>4. Oficer kontakti ndërlidhës, në Drejtorinë e Policisë së Shtetit dhe funksione të barasvlershme me to.</li> </ol> <p><b>B. <u>Në struktura e veçanta</u></b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Komandant i Repartit Special "RENEA";</li> <li>2. Specialist koordinator, në Drejtorinë e Studimeve Strategjike;</li> <li>3. Drejtor i Qendrës së Mbyllur të të Huajve të Kufirit dhe Migracionit;</li> <li>4. Shef Sektori në Drejtorinë e Antiterrorit, në Institutin e Policisë Shkencore, në Drejtorinë e Forcës së Posaçme Operacionale, në Drejtorinë e Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë dhe Drejtorinë e Teknologjisë së Informacionit dhe funksione të barasvlershme me to.</li> </ol> <p><b>C. <u>Në Akademinë e Sigurisë</u></b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Drejtor i Certifikimeve dhe Shërbimeve ndaj të Tretëve;</li> <li>2. Lektorë në Fakultet;</li> <li>3. Shef Sektori i Planifikimit dhe Kurikulave;</li> </ol>

		<p>4. Përgjegjës Departamenti ai zëvendës drejtor, në Kolegjin Profesional të Lartë dhe funksione të barasvlershme me to.</p> <p>5. <b><u>Në Drejtoritë vendore të Policisë</u></b></p> <p>1. Drejtor i Drejtorive Vendore, të Policisë Kufitare dhe Migracionit;</p> <p>2. Zëvendës drejtor, në Drejtoritë Vendore të Policisë.</p>
Kryekomisar	454	<p><b>A. Në strukturat e Drejtorisë së Policisë së Shtetit</b></p> <p>1. Specialist, në Drejtorinë e Policisë së Shtetit dhe Drejtoritë e Përgjithshme;</p> <p>2. Shef sektori për përgjimin e telekomunikimit, në Drejtorinë e Përgjithshme për hetimin e krimit të organizuar dhe krimet e rënda;</p> <p>3. Shef sektori i shërbimeve të policisë gjyqësore pranë P.K.R., në Drejtorinë e Përgjithshme për hetimin e krimit të organizuar dhe krimet e rënda;</p> <p>4. Specialist koordinator, në Sektorin (zyra) Qendrore Kombëtare INTERPOL, EUROPOL;</p> <p>5. Shef Qendre/Koordinator institucional, në Qendrën Ndërinstitucionale Operacionale Detare (QNOD), në Drejtorinë e Përgjithshme për Kufirin dhe Migracionin dhe funksione të barasvlershme me to.</p> <p><b>B. Në strukturat e veçanta të policisë.</b></p> <p>1. Komandant i Repartit të Ndërhyrjes së Shpejtë;</p> <p>2. Shef i Institutit të Përgatitjes së Qerve të Policisë;</p> <p>3. Shef sektori në Repartin Special "RENEA";</p> <p>4. Komandant i Repartit Special të Kufirit dhe Migracionit "DELTA";</p> <p>5. Komandanti i Repartit Special "RESI";</p> <p>6. Shef njësie/specialist në Njësinë Speciale të Antieksplozivave dhe në Njësinë Speciale të Negocimit;</p> <p>7. Komandant i Repartit të Sigurisë së Brendshme dhe Ceremonialit;</p> <p>8. Specialist koordinator me SHISH, specialist drejtimi, specialist në sektorin e analizës dhe kartotekës, shef njësie për tendencat e radikalizmit dhe ekstremizmit dhe shef i njësisë operacionale antiterrorizëm, në Drejtorinë e Antiterrorit;</p> <p>9. Specialist, në Drejtorinë e Antiterrorit, në Institutin e Policisë Shkencore, në Drejtorinë e Forcës së Posaçme Operacionale, në Drejtorinë e Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë dhe Drejtorinë e Teknologjisë së Informacionit dhe funksione të barasvlershme me to.</p>
		<p><b>C. Në Akademinë e Sigurisë</b></p> <p>1. Asistent lektorë në Fakultet dhe Qendrën e Kërkimeve Shkencore;</p> <p>2. Përgjegjës Departamenti në Kolegjin Profesional të Lartë;</p> <p>3. Shef Sektori i Trajnimit në Terren, në Kolegjin Profesional të Lartë;</p> <p>4. Shef Sektori në Drejtorinë e Certifikimeve dhe Shërbimeve ndaj të Tretëve;</p> <p>5. Shef Sektori i Burimeve Njerëzore;</p> <p>6. Shef Sektori i Menaxhimit dhe Kontrollit;</p> <p>7. Specialist për Kontrollin në Fakultet;</p> <p>8. Specialist për Planifikimin dhe Kurrikulën, në Sektorin e Planifikimit dhe Kurrikulave;</p> <p>9. Specialist për Marrëdhëniet me Jashtë, Cepol dhe funksione të barasvlershme me to.</p> <p><b>B. Në strukturat e Drejtorive vendore të Policisë</b></p> <p>1. Shef sektori në Drejtoritë Vendore të Policisë dhe Drejtoritë Vendore të Kufirit e Migracionit;</p> <p>2. Specialist asistent, në Drejtoritë Vendore të Policisë;</p> <p>3. Shef Komisariati, në Drejtoritë Vendore të Policisë dhe në ato të Kufirit dhe Migracionit me personel mbi 36 punonjës dhe funksione të barasvlershme me to.</p>
Komisar	536	<p><b>A. Në Drejtorinë e Policisë së Shtetit</b></p> <p>1. Specialist në sektorin për përgjimin e telekomunikimit;</p> <p>2. Specialist në sektorin e shërbimeve të policisë gjyqësore pranë P.K.R.</p> <p>3. Specialist, specialist për kërkimin, në Sektorin (zyra) Qendrore Kombëtare INTERPOL;</p> <p>4. Specialist, në Sektorin e Bashkëpunimit, Koordinimit Ndërkombëtar dhe Përkthimeve, në Drejtorinë e Policisë së Shtetit;</p> <p>5. Specialist për Syberworks, në Sektorin e Trajnimit dhe Përgatitjes, në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore;</p> <p>6. Koordinator institucional/specialist, në Qendrën Ndërinstitucionale Operacionale Detare (QNOD), në Drejtorinë e Përgjithshme për Kufirin dhe Migracionin dhe funksione të barasvlershme me to.</p> <p><b>B. Në strukturat e veçanta të policisë.</b></p> <p>1. Shef Seksioni, komandant njësie, në Repartin Special "RENEA", në Repartet Speciale, në Repartet e Ndërhyrjes së Shpejtë;</p>

	<p>2. Shef i Seksionit të Burimeve Njerëzore, në Repartet e Njësitë Speciale, Repartet e Ndërhyrjes së Shpejtë;</p> <p>3. Specialist koordinator ai zëvendëskomandant, specialist i trajnimeve dhe masave mbrojtëse, Shef i Njësisë Operacionale, në Repartin Special "REST";</p> <p>4. Zëvendëskomandant, Shef seksioni, në Repartin Special të Kufirit dhe Migracionit "DELTA";</p> <p>5. Shef i Qendrës së Drejtimit dhe Menaxhimit të Operacioneve Speciale, Shef Njësie/specialist në Drejtorinë e Forcës së Posaqme Operacionale, në Drejtorinë e Përgjithshme për hetimin e krimet të organizuar dhe krimet e rënda;</p> <p>6. Shef Njësie Operacionale, Shef Seksioni, në Drejtorinë e Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunorëve të Drejtësisë, në Drejtorinë e Përgjithshme për hetimin e krimet të organizuar dhe krimet e rënda;</p> <p>7. Shef njësie në sektorët e Drejtorisë së Forcës së Posaqme Operacionale në Drejtorinë e Përgjithshme Kundër Krimet të Organizuar dhe Krimeve të Rënda;</p> <p>8. Shef Seksioni dhe Shef Stacioni, në Repartin e Sigurisë së Brendshme e Ceremonialit, në Institutin e Përgatitjes së Qerave të Policisë dhe në Qendrën e Mbyllur të të Huajve të Kufirit dhe Migracionit;</p> <p>9. Specialist në Njësinë Operacionale Antiterrorizëm dhe specialist në njësitë për tendencat e radikalizmit dhe ekstremizmit, në Drejtorinë e Antiterrorit dhe funksione të barasvlershme me to.</p> <p><b>C. <u>Në Akademinë e Sigurisë</u></b></p> <p>1. Shef Seksioni në Kolegjin Profesional të Lartë;</p> <p>2. Shef i seksionit të Sigurisë;</p> <p>3. Specialist/instruktor, në Kolegjin Profesional të Lartë dhe në Drejtorinë e Certifikimeve dhe Shërbimeve ndaj të Tretëve;</p> <p>4. Specialist për kontrollin e njohurive, specialist për menaxhimin e kurseve, specialist për kontrollin në kolegji, në Sektorin e Menaxhimit dhe Kontrollit dhe funksione të barasvlershme me to.</p> <p><b>D. <u>Në Drejtoritë vendore të Policisë</u></b></p> <p>1. Shef Komisaritet, në Drejtoritë Vendore të Policisë dhe në ato të Kufirit dhe Migracionit me personel deri në 36 punonjës.</p> <p>2. Shef Seksioni, në Drejtoritë Vendore të Policisë dhe ato të Kufirit dhe Migracionit;</p> <p>3. Shef Seksioni, në Komisaritet e Policisë, në Drejtoritë Vendore të Policisë dhe ato të Kufirit dhe Migracionit;</p>
--	---

	<p>4. Shef Stacioni, në Komisaritet e Policisë në Drejtoritë Vendore të Policisë dhe në strukturat e Kufirit dhe Migracionit dhe funksione të barasvlershme me to.</p>
Nëkomisar	<p><b>A. <u>Në Drejtorinë e Policisë së Shtetit</u></b></p> <p>1. Oficerë të turnit, specialist, në Qendrën Ndërinstitucionale Operacionale Detare (QNOD), në Drejtorinë e Përgjithshme për Kufirin dhe Migracionin dhe funksione të barasvlershme me to.</p> <p><b>B. <u>Në strukturat e veçanta të policisë.</u></b></p> <p>1. Zëvendëskomandant njësie, Specialist, në Repartin Special "RENEA", në Repartet Speciale, në Repartet e Ndërhyrjes së Shpejtë;</p> <p>2. Zëvendës shef njësie, në Drejtorinë e Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunorëve të Drejtësisë, në Drejtorinë e Përgjithshme për hetimin e krimet të organizuar dhe krimet e rënda;</p> <p>3. Specialist në Njësinë Speciale të Antieksplzivave dhe në Njësinë Speciale të Negocimit ,</p> <p>4. Specialist në Institutit të Përgatitjes së Qerave të Policisë,</p> <p>5. Specialist, në Repartin Special të Kufirit dhe Migracionit "DELTA",</p> <p>6. Specialist në Qendrën e Mbyllur të të Huajve të Kufirit dhe Migracionit.</p> <p>7. Specialist turni dhe Informacioni dhe funksione të barasvlershme me to.</p> <p><b>C. <u>Në Akademinë e Sigurisë</u></b></p> <p>1. Specialist për disiplinën, në Fakultet dhe Kolegjin Profesional të Lartë;</p> <p>2. Specialist për trajnimet;</p> <p>3. Përgjegjës turni dhe Informacioni dhe funksione të barasvlershme me to.</p> <p><b>D. <u>Në Drejtoritë vendore të Policisë</u></b></p> <p>1. Specialist, në Drejtoritë Vendore të Policisë dhe Specialist në Drejtoritë Vendore Kufirit dhe Migracionit;</p> <p>2. Specialist , në Komisaritet e Policisë;</p> <p>3. Specialist, në Komisaritet e Kufirit dhe Migracionit;</p> <p>4. Shef Poste Policie;</p> <p>5. Specialist, në stacionet e Policisë;</p>

		6. Specialist, në Seksionet dhe Stacionet e Policisë Kufitare; 7. Përgjegjës turni, në Seksionet dhe Stacionet e Policisë Kufitare dhe funksione të barasvlershme me to.
<b>Inspektor</b>		1. Punonjësit e policisë që përfundojnë Shkollën Bazë të Policisë; 2. Ndihmës specialist, në të gjitha strukturat e Policisë së Shtetit; 3. Oficer i Patrullës së Përgjithshme, në Komisarariatet e Policisë; 4. Përgjegjës grupi, në të gjitha strukturat e Policisë së Shtetit; 5. Trupë shërbimi operacional, në të gjitha strukturat e Policisë së Shtetit; 6. Trupë shërbimi, në të gjitha strukturat e Policisë së Shtetit; 7. Komandant skuadre, në të gjitha strukturat e Policisë së Shtetit dhe funksione të barasvlershme me to.